



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR

**Këshilli
Konsultativ**



Procesverbali i Mbledhjes

**Këshilli Konsultativ mes Qeverisë Qendrore dhe Qeverisë Vendore
Mbledhja e datës 3 shkurt 2026**

Tabela e Përmbajtjes

Hapja e mbledhjes.....	1
1. Projektvendimi “Për një ndryshim në Vendimin nr. 419.datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.....	2
2. Projektvendimi “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 328, datë 31.5.2023 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur të emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar.....	9
3. Projektvendimi “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 425, datë 26.6.2024 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jo mësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor para universitar”.....	10
4. Projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë Rrugore 2030 dhe Planit të Veprimit 2026-2028”.....	10
5. Projektvendimi “Për miratimin e Planit Kombëtar për përshtatjen ndaj dryshimeve klimatike 2026-2036”.....	11
Shtojcë: Të pranishëm	14

Hapja e mbledhjes

Në zbatim të VKM nr. 244, datë 17.4.2024 të Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”, më datë 3 shkurt 2026 u zhvillua mbledhja e Këshillit Konsultativ Mbledhja u zhvillua online në platformën Microsoft Teams. Në mbledhje morën pjesë anëtarët e Këshillit Konsultativ, përfaqësues nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe donatorë të huaj.

Mbledhja u kryesua nga bashkëkryetari i Këshillit Konsultativ, *Z. Aldrin Dalipi, Kryetar i Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë*, i cili, në fjalën e tij përshëndetëse, falënderoi shoqatat dhe përfaqësuesit e NJVV-ve.

PROJEKTAKTE TË KONSULTUARA

Znj. Enkela Dudushi, Drejtor, Departamenti i Administratës Publike, prezantoi paketen ligjore të sjellë nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin.

1. Projektvendimi “Për një ndryshim në Vendimin nr. 419.datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”

Znj. Dudushi sqaroi se në thelb të të gjitha propozimeve në fakt ka qenë indeksimi prej 2,5 për qind, me disa përjashtime të vogla, të cilat kanë ardhur për shkak të rregullimeve që duhet të bëheshin meqenëse paga minimale në shkallë vendi u rrit me u bë 50.000 lekë, pra u rrit me 10.000 lekë të reja dhe për këtë arsye ishte e domosdoshme që për të gjitha nivelet e tjera të kishim dhe një politikë ekstra. Projektvendimi që propozon rritjen e pagave për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin që janë rritur në një masë më të madhe se sa 2,5 për qind janë gradat më të ulëta të rolit bazë dhe konkretisht asistent zjarrfikës është rritur me 5.000 lekë të reja, që është më shumë se sa 2,5 për qind. Zjarrfikësit me gradën zjarrfikës janë rritur me 4.000 lekë të reja, Kryezjarrfikësi me 3.500 lekë dhe nënkomisari me 3.000 lekë, pastaj të gjitha gradat e tjera, pavarësisht vlerës absolute që është 3.000 lekë dhe më shumë ajo në fakt i korrespondon masës prej 2,5 për qind. Pra për këtë shërbim është rritur në masë nga 5 deri në 8,33 për qind gradat e ulëta dhe me 2,5 për qind të gjitha gradat e tjera.

Komente;

Z. Dritan Lika, Drejtor Finance, bashkia Fushë-arrëz shtroi shqetësimin për pagat e zjarrfikësve, janë në shërbim 24 orë. dhe nuk trajtohen me shtesa për turnet, siç e ka kodi i punës për turnin e

2-të apo për turnin e 3-të

2. Projektvendimi “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 328, datë 31.5.2023 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur të emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar

Znj. Dudushi sqaroi se pagat e pushtetit vendor, gjithë punonjësve të njësive të propozohet një rritje me 2.5 për qind e kufijve minimal dhe maksimal për të gjitha pozicionet e zgjedhura dhe të emëruara. Pra, kabinetet dhe të tjera në njësitë e vetëqeverisjes vendore kemi një rritje me 2,5 për qind të të gjithë kufijve minimal të të gjithë nëpunësve civilë dhe nëpunësve të tjerë që i referohen shërbimit civil në bashki. Rritje me 2,5 për qind, pra indeksim.

Për kufijt maksimal të klasave nga klasa 1.2 deri në klasën 2.2 dhe rritje me më shumë se sa 2,5 për qind të kufijve maksimal për klasat e tjera. Pra, klasat që i përkasin përgjegjësve të sektorit dhe specialistëve. Rritja është bërë edhe këtu e njëjtë me nëpunësit civil të institucioneve të administratës shtetërore, pra është ruajtur e njëjta logjikë që u përdor edhe në vitin e fundit. Ndërkohë, për punonjësit mbështetës, pra atyre që ne i themi punonjës të pakualifikuar, rritja është me 10.000 lekë. Gjithmonë, kanë qenë kufij 40-47.000 lekë janë bërë 50 -57.000 lekë në të njëjtën masë, aq është rritur dhe për punonjësit mbështetës në institucionet e administratës shtetërore.

Komente:

Znj. Brunilda Mersini, kryetare e bashkisë Vlorë sqaroi se bashkia Vlorë vazhdon të operojë me vendimin e 2016 ku paga është 54 900 lekë referuar ligjit për policisë bashkiake, ata aplikojnë me shkollë të mesme, ku ndërkohë gjitha burimet njerëzore janë me shkollë të lartë dhe kjo ka qenë debat i kahershëm dhe i pazgjidhur edhe nga këshilli bashkiak. Kështu që, do të ishte shumë mirë në qoftë se do të ndërhynin edhe për këtë kategori.

Znj. Dudushi argumentoi se për policinë bashkiake që kur ka ndryshuar ligji para ca vitesh nuk e bën më rritjen e pagave vendimi i Këshillit të Ministrave por, është vendimi i këshillit bashkiak që ju përcakton pagat duke iu referuar pagave të pjesës tjetër të punonjësve që përcakton vendimi i Këshillit të Ministrave. Prandaj lidhja e policisë bashkiake nuk është më në lidhjen përkatëse në vendimin përkatës të pagave të pushtetit vendor.

Znj. Mersini theksoi se ne që në aplikim i paguajmë jo si specialist por, i paguajmë me shkollë të mesme dhe kjo është ajo që e kemi pa rregulluar nga baza ligjore. *Znj. Dudushi* theksoi se vendimi citon që për institucionet që krijojnë bashkia i përcakton vetë pagat këshilli bashkiak duke iu referuar pagave të pjesës tjetër të punonjësve që janë të përcaktuar me vendim të këshillit të ministrave, që do të thotë që ju i merrni për referencë, duke vlerësuar cila është rëndësia e pozicionit të punës dhe këshilli bashkiak përcakton vlerën e pagës në referencë me atë që ne kemi përcaktuar për pjesën

tjetër të punonjësve. Nuk është e thënë që juve me patjetër do duhet që për policinë bashkiake ti vendosni të njëjtën strukturë page, pra të njëjtët element page, si për ata me arsim të lartë, që do të thotë në qoftë se juve keni një punonjës policie bashkiake, çfarëdolloj pozicioni me arsim të mesëm, ju i vendosni pagën një vlerë fikse, e cila mund t'i takojë dhe pozicionit, vlerës së pozicionit të një specialisti.

Znj. Mersini theksoi se duke qenë se referenca që i japin burimeve njerëzore është që i jemi referuar vkm-së 2016-ës, ku ata pikërisht duke qenë se nuk janë specialist, sepse nuk kalon pozicioni i shkollës mesme për tu quajtur specialist dhe ky ka qenë gjithmonë ngërçi. Paga ka qenë e shprehur në atë kohë 54 900 lekë por, prapë e ulët.

Znj. Dudushi sqaroi se 54 900 lekë ka qenë vlera e pozicionit, por që në 2016 e deri sot janë rritur të gjitha pagat dhe nuk duhet të jetë prapë 54.900 lekë të bashkia juaj. Këshilli bashkiak ka kompetencën të përcaktojë pagat e institucioneve që krijon vetë apo të ndërmarrjeve që krijon vetë duke iu referuar tabelës së pagave të miratuar nga Këshilli i Ministrave, kufijtë minimal dhe maksimal për aparatet e bashkive. Pra, për pjesën e aparatit të bashkisë, në momentin që këshilli i ministrave miraton këtë, këshilli bashkiak miraton pjesën tjetër për ndërmarrjet tuaja dhe për institucionet që ju krijoni. Nuk ka asnjë pengesë ligjore në këtë mes dhe e kam sqaruar edhe në mbledhjen që është bërë vjet në këshillin konsultativ. Është ngritur i njëjti problem nga bashkitë, ku pagat për policinë bashkiake nuk miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, sepse sipas ligjit të policisë bashkiake është institucion në varësi të bashkisë.

Z. Qerim Ismailaj, Kryetar i bashkisë Mallakastër sqaroi se për pagat e policisë bashkiake, edhe pse iu referua si institucion, policia bashkiake është pjesë e strukturës, nuk është institucion, siç mund të jenë ndërmarrjet ose agjencitë e shërbimeve, të cilat operojnë si institucion në varësi të bashkisë. Kjo kërkon një rregullim, përtej asaj që është dhënë normalisht. Pagën e specialistit për administratën e policisë bashkiake e kam çuar 59.000, por pa patur një bazë të qartë ligjore. *Znj. Dudushi* sqaroi se policia bashkiake nuk mund dhe nuk është pjesë e aparatit të bashkisë. Funkcioni që bën policia bashkiake nuk mund të jetë strukturë e bashkisë dhe i bie që edhe Inspektoriatet e Mbrojtjes së Territorit, ti keni pjesë strukturës bashkisë, gjë që nuk është pjesë e strukturës e aparatit të bashkisë. Policia bashkiake nuk ka qenë kurrë dhe nuk mund të jetë në logjik pjesë e aparatit të bashkisë, është një institucion varësie i bashkisë. Sigurisht është pjesë e juaja, është e njësisë së qeverisjes vendore, i takon bashkisë, por jo pjesë e aparatit. Pagat e policisë bashkiake i përcakton këshilli bashkiak si institucion varësie, njësoj të gjithë institucionet e tjera.

Z. Ismailaj shtroi pyetjen për punonjësit e administratës si topograf, specialist, manovratorë me mjetet e rënda, shoferët e kamionëve të rëndë, ku nuk mund të trajtohet njësoj një manovrator kur tregu i punës sot e ka 120.000 -150.000 lekë pagën mujore neto për këtë kategori.

Znj. Dudushi sqaroi se pika e vendimit ku citon kufijtë për punonjësit mbështetës është 50.000 lekë deri në 57.000 lekë. Kjo vlerë është e njëjtë si edhe në pjesën tjetër të administratës shtetërore. Pra, nuk mundemi të bëjmë një rritje më të madhe, ka qenë 40.000 lekë-47.000 leke dhe është rritur me 10.000 lekë të reja të 2 kufijtë, me një rritje më të madhe se pjesa tjetër. Pra, kjo është rritja që është bërë dhe për administratën shtetërore, dhe nuk ka asnjë ndryshim. Nuk mund të shkojmë në 70.000 lekë në rastin e bashkisë, sepse 57.000 lekë e kemi rastin tjetër këtej në administratë shtetërore.

Znj. Vasilika Vjero, Nënkryetare e bashkisë Tiranë, shtroi shqetësimin se vendimet miratohen pak me vonesë, ndërkohë që kishte qenë mirë të kishim kapur muajin e kaluar për ti vënë edhe më përpara gjërat dhe për të kaluar dhe miratimin në këshillat bashkiak

Znj. Farrici, Drejtoreshë Ekzekutive, SHKBSH, sqaroi se paga minimale është 50.000 lekë dhe mbi bazën e saj që në fakt kategoria e 4/2 specialist inspektor paga minimale duhet të shkoj 65.000 lekë, pra të mos mbetet në minimumin e pagës minimale, pasi kemi bëjmë për punonjës që janë me master. Pjesa e disa profesioneve që kanë vështirësi të veçanta dhe që paguhen me një nivel shumë të lart në privat, këshilli bashkiak mund të vendos paga për nivele punonjësish të profesioneve të veçanta teknike.

Znj. Dudushi argumentoi se nuk ka pse të shtohet në vendim një pikë tjetër sepse është këshilli bashkiak që përcakton strukturën, pra elementët e pagës dhe pagat për të gjitha institucionet apo ndërmarrjet në varësi të saj. Në këtë kuptim mund të marrin që paga e manovratorit është aq lekë dhe merr përveç kësaj dhe një përqindje vështirësi profesioni.

Znj. Dudushi sqaroi se asnjë bashki nuk japin minimumin i cili sigurohet nga shteti.

Znj. Farrici shtroi se paga minimale është 46.000 lekë, nuk mund të pranohet kur paga minimale është 50,000 lekë, i cili është një problem shumë i mprehtë për bashkitë.

Znj. Dudushi sqaroi se specialisti e ka minimumi 56.000 lekë se ka dhe 10.000 lekë nëse është me bachelor.

Z. Ismailaj shtroi pyetjen për funksionet e deleguara si arsimin parauniversitar, ku sekretari i shkollës e ka pagën 44.100 lekë duhet të paguhet me pagën minimale si përgjegjësi i zyrës së gjendjes civile që minimalisht duhet të jetë me bachelor.

Znj. Dudushi sqaroi se përgjegjësit e zyrës nga vetë emri nuk mund të jetë me arsim të mesëm.

Z. Erion Isai, kryetar i bashkisë Kolonjë, dakordësoi me propozimet e *znj. Farrici* dhe sqaroi se paga minimale është 50.000 dhe nuk futen shtesat, as të diplomës, si dhe as të vështirësisë në punë.

Znj. Dudushi sqaroi se administrata shtetërore nuk prodhon të ardhura që të ketë kufi minimal dhe maksimal. Administrata shtetërore është totalisht buxhetore. Këshilli i Ministrave miraton kufijtë

minimal dhe maksimal dhe këshilli bashkiak miraton brenda këtyre kufijve, varësisht çfarë subvencionon buxheti dhe çfarë të ardhurash ka vetë, si dhe gjithë pjesën tjetër se ku duhet të shkojë secila page, secili pozicion pune. Pra, kjo është ky është sistemi i ngritur për bashkitë.

Z. Dritan Lika, Drejtor për Financat në bashkinë Fushë arrëz sqaroi se trajtimi i arsimit të mesëm me 50.000 lekë deri në 57.000 lekë duhet të kihet një diferencim për teknikë të mesëm. Për shembull, kemi teknikë, topograf i mesëm që nuk mund të trajtohen me të njëjtën pagë siç trajtohet një punonjës me gjimnaz dhe e njëjtë me teknikët e pyjeve. Ndryshimet e pagës minimale në bashki duhet të shoqërohen me buxhetin e duhur për përballimin e kostove të indeksimit të pages. *Znj. Alma Hoxha, kryetare e bashkisë Permet*, shtroi shqetësimin se për pozicionin me 40.000 lekë, bashkia e Përmetit ka plot punonjës me këtë pagë që janë me arsim të lartë me bachelor. Sigurisht që s'kanë vjetërsinë se janë të rinj por, një punonjës i arsimit të mesëm paguhet më shumë se një punonjës i arsimit të lartë.

Znj. Mersini paraqiti relacionin në mënyrë elektronike drejtuar agjencisë për tu reflektuar nga institucioni përkatës referuar projektvendimit “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 328 datë 31.5.2023 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur, të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore” të ndryshuar, mbi përcaktimin e nivelit të pagave për punonjësit e Policisë Bashkiake si më poshtë;

Në Vendimin nr. 165, datë 2.3.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, struktura dhe kufijtë e pagave për punonjësit e Policisë Bashkiake pranë bashkive përcaktoheshin në Lidhjen nr. 8, si më poshtë:

Lidhja nr. 8

Struktura dhe kufijtë e pagave për punonjësit e policisë bashkiake pranë bashkive

Emërtesa/pozicioni	Paga (lek/muaj)	
	Nga	Deri
Kryeinspektor i Policisë Bashkiake të Tiranës	84.500	104.000
Kryeinspektor i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore me 200001 deri në 400000 banorë dhe me mbi 400.000 banorë	69.500	84.700
Kryeinspektor i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore me 100001 deri në 200.000 banorë	67.400	82.400
Kryeinspektor i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore me 50001 deri në 100.000 banorë	65.200	81.800
Kryeinspektor i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore me 20001 deri në 50.000 banorë	54.600	65.200

Kryeinspektor i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore me deri në 20.000 banorë	53.000	61.300
Inspektor i Policisë Bashkiake të Tiranës	65.200	81.800
Inspektor i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore me 200001 deri në 400000 banorë dhe me mbi 400.000 banorë	53.000	61.300
Inspektor i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore me 100001 deri në 200.000 banorë	51.400	59.500
Inspektor i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore me 50001 deri në 100.000 banorë	48.100	59.500
Inspektor i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore me 20001 deri në 50.000 banorë	42.800	51.000
Inspektor i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore me deri në 20.000 banorë	40.600	49.200
Punonjës i Policisë Bashkiake të Tiranës	53.500	63.000
Punonjës i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore, me 200001 deri në 400000 banorë dhe me mbi 400.000 banorë	47.000	54.900
Punonjës i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore, me 100001 deri në 200.000 banorë	44.400	52.700
Punonjës i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore, 50001 deri në 100.000 banorë	42.800	51.000
Punonjës i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore, me 20001 deri në 50.000 banorë	40.600	49.200
Punonjës i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore me deri 20000 banorë	38.500	47.500

Me miratimin e VKM-së nr. 328 datë 31.5.2023 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimive të njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur, të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, u evidentua mungesa e lidhjes e cila përcakton nivelin e pagave për punonjësit e policisë bashkiake. Në këto kushte Bashkia Vlorë në miratimin e nivelit të pagave në zbatim të kësaj Vkm-je nuk bëri ndryshime duke mos patur një referencë për pagën e re.

Vlen të theksohet se në Ligjin nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake” neni 12 pika ç, përcaktohet se kriter i arsimit për tu pranuar në policinë bashkiake është “*të ketë përfunduar arsimin e mesëm të lartë...*”. Për rrjedhojë nuk mund të marrim për referencë nivelet e pagave të përcaktuara në lidhjen nr. 3 të VKM-së nr. 503 datë 1.8.2024.

Lidhja nr. 3 Nivelet e pagave për nëpunësit civilë në bashkitë me mbi 200.000 banorë

Kategoria	Klasa	Emërtesat e pozicioneve të punës për çdo kategori	Grupi i diplomës	Paga për pozicion
1	2	3	4	5
I	I-3	Sekretar i Përgjithshëm	1	Nga 100,000 deri 205,000
	I-5	Drejtor i Përgjithshëm	1	Nga 95,000 deri 170,000
II	II-2	Drejtor drejtorie	1	Nga 85,000 deri 141,000
III	III-2	Përgjegjës sektori	1	Nga 70,000 deri 105,000
	III-3	Përgjegjës sektori	1	Nga 65,000 deri 98,000
IV	IV-2	Specialist Inspektor	1 ose 2, ose 3	Nga 45,000 deri 80,000
	IV-3	Specialist	1 ose 2 ose 3	Nga 42,000 deri 70,000
	IV-4	Specialist.	1 ose 2 ose 3	Nga 40,000 deri 60,000

Këshilli Bashkiak ka kompetencën për miratimin e nivelit të pagave për punonjësit e qeverisjes vendore, sipas Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Megjithatë në projektvendimin e

paraqitur nga administrata e bashkisë Vlorë kërkohet referencë ligjore për nivelin e pagës dhe mënyrën e llogaritjes së vjetërsisë në punë.

Propozojmë përcaktimin e referencës së nivelit të pagës dhe mënyrën e llogaritjes së vjetërsisë për punonjësit e Policisë Bashkiake, në një lidhje të veçantë të Projektvendimit që është duke u diskutuar.

3. Projektvendimi “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 425, datë 26.6.2024 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jo mësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor para universitar””

Znj. Dudushi sqaroi se dhe për vendimin për arsimin para universitar është ndjekur e njëjta logjikë. Edhe këtu janë indeksuar me 2.5 përqind të gjitha pozicionet e larta dhe specifikisht ato që i përkasin pushtetit vendor, që në fakt është lidhja 3 e projektvendimit që ka ardhur për mendim te juve dhe të gjitha pozicionet që vijnë nga përgjegjës sektori në qendrat kulturore deri te edukatori në kopsht fëmijësh janë rritur në një masë më të madhe mesatarisht 4 deri në 5 për qind, pra më shumë sesa indeksimi.

Komente:

Z. Lika shtroi çështjen që është sekretaria nëpër shkolla, ku një sekretar me arsim të lartë që trajtohet me një pagë shumë të vogël.

4. Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë Rrugore 2030 dhe Planit të Veprimit 2026-2028””

Z. Nikolin Berxhiku, Specialist, Sektori i Sigurisë Rrugore, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë prezantoi projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Sigurisë Rrugore 2030 dhe Planit të Veprimit 2026-2028””

Strategjia e sigurisë rrugore synon të përmirësojë sigurinë rrugore në përgjithësi, me qëllim kryesor reduktimin e fataliteteve rrugore në linjë me vizionin e bashkimit europian për rrugë më të sigurta. Hartimi i strategjisë për vetë natyrën ndërsektoriale, përfshirjen e shumë institucioneve u realizua me asistencën teknike të Bashkimit Europian.

Strategjia dhe objektivi i përgjithshëm i strategjisë së sigurisë rrugore është që deri në vitin 2030 të reduktohen fatalitetet e aksidenteve me 30% krahasuar me vitin 2021. Strategjia e sigurisë rrugore ndjek parimet e qasjes së një sistemi të sigurt, duke u përqendruar te përmirësimi i menaxhimit të sigurisë rrugore, infrastrukturë më e sigurt, automjete dhe përdorues të sigurtë të rrugës dhe emergjenca efikase. Secila prej këtyre elementëve thellohet në këtë strategji dhe në planin e veprimit. Përmirësimi i kapaciteteve ka parasysh krijimin e një sistemi mbrojtës efektiv për sigurinë rrugore me një qeverisje të qartë dhe me komunikim, bashkëpunim dhe koordinim efektiv mes aktorëve kryesorë të sigurisë rrugore në zbatimin e ndërhyrjeve të rënda.

Rritja e sigurisë së rrugëve, sigurimi i rrugëve në mënyrë që shumica e udhëtimeve të kryera në rrugë të projektuara në mënyrë të sigurt, të ndërtuara mirë dhe të mirëmbajtura rregullisht me një risk më të ulët aksidentesh. Siguria e mjeteve, përmirësimi i standardeve të sigurisë së mjeteve për të mundësuar një siguri më të lartë në qarkullim dhe për të përmirësuar lidhjen mes faktorëve mjet-rrugë-njeri me synim përmirësimin e standardeve të sigurisë së mjeteve në përputhje me legjislacionin e bashkimit europian. Nxitja e një kulture të fortë për sigurinë rrugore rritja e njohurive, qëndrimeve dhe sjelljeve të përdoruesve të rrugës në një nivel të krahasueshëm me mesataren e vendeve anëtare të bashkimit europian, duke monitoruar nga afër treguesit kryesorë të performancës. Së fundmi, është përmirësimi i sistemeve të reagimit, sistemeve të emergjencës, kujdesi pas aksidentit dhe rehabilitimit, ku kam parasysh sigurimin e një reagimi emergjent efektiv dhe në kohë të kujdesit pas aksidentit dhe rehabilitimi që do të maksimizojë mbijetesën dhe rikuperimin pas aksidenteve në përputhje me praktikatat më të mira të bashkimit europian. Strategjia e sigurisë rrugore bashkëshoqërohet nga plani i veprimit 2026-2028. Plan i veprimit përmban fushat kryesore, ndërhyrjet specifike, masat dhe aktivitetet, institucionet kryesore përgjegjëse dhe mbështetëse, kornizën e financimit dhe treguesit e synuar për monitorimin, vlerësimin e ndikimit të masave. Në këtë plan veprimi i kemi veçuar cilët pritet të jenë kontributet e pushtetit vendor. Krijimi i grupeve të ekspertëve lokalë në bazë prefekturë për propozime masash me kosto jo të mëdha, për grupet e ekspertëve ekziston një rregullore e hershme e këshillit të ministrave ku përcaktohet një skemë organizative për sigurinë rrugore si në nivel qendror dhe lokal. Grupet e ekspertëve lokalë kryesohen nga prefekti dhe ka në përbërje kryesisht përfaqësues të bashkive, por edhe të institucioneve qendrore me përfaqësi të degëve lokale si drejtoritë rajonale të policisë së shtetit. Megjithatë duhet thënë që përveç prefekturës, Dibrës, e cila ka qenë mjaft e rregullt dhe në takimet dhe në informacionet e dërguara në prefekturat e tjera, nuk kemi informacione që të ketë mbledhje të rregullta. Si kontribut në planin e veprimit nga këto grupe priten rekomandime, masa konkrete që bashkitë duhet të aplikojnë së bashku me organizmat e tyre. Pritet dhe një angazhimi në drejtim të sensibilizimit për sigurinë rrugore për komunitetet lokale. Për shembull, mund të jenë fletë palosje me mesazhe të shkurtra kundrejt grupeve të caktuara kryesisht, nxënës shkollash, të moshuar, të rinj, duke mbështetur nga organizata lokale të varësisë, por edhe shoqërisë civile të cilat operojnë në këtë fushë. Mund të kërkohet ndihma e specializuar për mesazhet kryesore të fushatës në drejtorinë e policisë, në ministrinë e infrastrukturës, me organet e saj të varësisë, kryesisht drejtoria e përgjithshme e shërbimeve të transportit rrugor mund të replikohen këto mesazhe fushatave sensibilizuese në faqet e internetit të institucioneve përkatëse, duke i bashkëlidhur në faqet e mediave sociale të këtyre institucioneve, sidomos kur ka edhe fushata në nivel qendror për këtë qëllim. Një kontribut tjetër është rishikimi i kufijve të shpejtësisë dhe masa të lidhura që ndikojnë në përshtatjen e shpejtësisë sipas mjedisit rrugor.

Shpejtësia e lartë është shkaktare kryesore e ndodhjes së aksidenteve dhe grupet vulnerabël të

rrugës si këmbësorët, çiklistët, motoçiklist apo të mjeteve të tjera bashkëkohore të transportit personal kanë qenë viktimë të aksidenteve. Sipas detyrimeve që përcakton kodi rrugor, duhen parë kufijtë e shpejtësisë në segmentet e rrugëve kombëtare që kalojnë në zonat e qytetit, në qendrat e qyteteve, zonat shkollare etj. Kujtojmë se bashkitë janë përgjegjëse për sinjalizimin rrugor në segmentet ku kalojnë rrugët kombëtare në territoret e tyre dhe shpesh nuk dallohet se qarkullohet në një zonë të banuar dhe kufiri i shpejtësisë vazhdon të mbetet i lartë. Si dhe në zonat pranë shkollave, siç janë edhe masat e aplikuara, për shembull në Tiranë, pranë shumë shkollave të qytetit. Një aspekt tjetër është edhe kryerja e investimit që aplikojnë inovacione teknologjike që përmbajnë sinjale elektronike apo mesazhe të sigurisë rrugore dhe këtu mund të shihet mundësia e ndërveprimit me projekte të ndryshme, siç është qendra kombëtare e monitorimit të trafikut apo projektit smart city. Përmirësimi i shërbimit zjarrfikës, këtu kemi parasysh bashkëpunimin si aktivitet mbështetës në koordinim me Ministrinë e Brendshme dhe qendrën e drejtorisë së përgjithshme të emergjencave kombëtare. Lidhur me financimin e kësaj strategjie, duke konsideruar rëndësinë e mbulimit të kostove për çdo aktivitet në planin e veprimit 2026- 2028, janë përcaktuar institucionet të cilat duhet të vazhdojë të angazhojnë fondet si nga buxheti i shtetit. Burime të brendshme si administrative dhe investime apo donatorë të ndryshëm, sigurimi i të cilave krijon qëndrueshmëri financiare të aktiviteteve të propozuara. Ministria e Financave ka sugjeruar gjithashtu që në lidhje me këtë plan veprimi, bazuar edhe në nenin 22 të ligjit për vetëqeverisjen vendore, ku përcaktohet se në rastet kur njësitë e vetëqeverisjes vendore nuk zotërojnë fondet apo mjete të mjaftueshme për arritjen e standardeve dhe normave kombëtare, qeverisja qendrore u jep atyre mbështetjen e nevojshme financiare.

Komente:

Znj. Adelina Farrici ngriti pyetjen sa i përket krijimit të një ekspertize lokale në bazë prefekturë.

Z. Berxhiku sqaroi se këto grupe ekspertësh do të jenë të organizuar, prefekti kryeson këto grupe në nivel prefekturë, ku do të jenë përfaqësues të bashkive, por edhe anëtarë të drejtorive rajonale të institucioneve qendrore, siç është policia rrugore dhe drejtoria e shërbimeve të transportit rrugor.

Znj.Farrici ngriti pyetjen përse i përket kostove të përlllogaritura dhe kostove shtesë për pushtetin lokal dhe nëse janë planifikuar se çdo strategji duhet të shoqërohet edhe me veprime konkrete e cila ka nga pas një faturë financiare.

Z. Berxhiku vijoi se të gjitha aktivitetet kanë një përlllogaritje të kostos të veçantë për pushtetin lokal dhe se ekzistojnë mundësi për mbështetjen me fonde të qeverisjes vendore.

5. Projektvendimi “Për miratimin e Planit Kombëtar për përshtatjen ndaj dryshimeve klimatike 2026-2036”

Znj. Fatjona Çinaj, Drejtor, Drejtoria e Klimës, Ministria e Mjedisit prezantoi projektvendimin

“Për miratimin e Planit Kombëtar për përshtatjen ndaj dryshimeve klimatike 2026-2036”, e cila vijoi me arsyen pse nevojitet një plan kombëtar përshtatje deri në këtë moment. Shqipëria ka pasur një plan kombëtar përshtatje si pjesë e strategjisë, e cila në fakt evidentuar disa boshllëqe në pjesën e implementimit, përveç faktit që kemi disa detyrime sa i takon përputhshmërisë, për shkak të pozicionit të saj bregdetar dhe për shkak të rrethanave socio-ekonomike dhe institucionale, përballet me rreziqet klimatike. Dhe kështu për të mobilizuar edhe për të përcaktuar masa më të qarta se si vendi jonë do të përshtatet, u nis një proces i planifikimit dhe jo thjesht hartimi i dokumentit.

Ky proces ka pasur një konsultim të gjerë dhe ka nisur prej vitit 2021, duke filluar me pushtetin lokal, ku si pjesë e procesit të planifikimit të planit kombëtar të përshtatjes ka qenë edhe hartimi i planeve lokale të përshtatjes për tetë bashki të vendit, në mënyrë që masat që identifikoheshin në nivel lokal të mund të integroheshin edhe në nivel kombëtar. Procesi u zhvillua sipas metodologjisë përmes një sërë vlerësimesh të analizave të gjëra teknike të bazuara në të dhëna, studime dhe programe për ngritjen e kapaciteteve dhe shërbeu si bazë për hartimin e këtij plani. Baza kryesore e të cilës është ku janë bazuar edhe prioritizimi i sektorëve prioritarë, siç janë turizmi, bujqësia dhe pyjet, zhvillimi urban, energjia, transporti, ku të pesë sektorët po përballen me rritje të ndjeshme, dhe të cenueshmërisë ndaj rreziqeve klimatike dhe kjo nënvizoi nevojën urgjente për të identifikuar masat e synuara me qëllim uljen e rreziqeve, forcimin e qëndrueshmërisë. Turizmi është një sektor i shtuar në planin kombëtar të përshtatjes, duke qenë se vitet e fundit ka pasur një kontribut të shtuar. Megjithatë, nga ana tjetër ka qenë një nga sektorët e evidentuar më të cenueshëm ndaj ndryshimeve klimatike. Procesi ka përfshirë edhe nivelin lokal dhe në këtë proces janë evidentuar 683 masa, të cilat janë prioritizuar. Ndërkohë në nivel kombëtar nga 200 masa rreth 200 masa të evidentuara, duke u njësuar dhe masat lokale. Kemi konkluduar në 66 masa prioritare për prioritare të planit kombëtar përshtatjes, nga të cilat 45 masa të buta, që do të thotë që përqendrohen në sistemet e institucionale rregullatore. Ndërkohë fola pak më parë për pjesën e analizës së realizuar për evidencë për prioritizimin e 60-të e 6-të masave që përmban ky plan kombëtar dhe që shoqërohet nga plani i veprimit. Duke marrë parasysh vlerësimin e qëndrueshmërisë financiare, teknike dhe institucionale, të ka qenë kriter kryesor dhe më tej ato kanë kaluar në analizën e kosto përfitimit.

Në konkluzion, masat prioritare për zbatimin e tyre do të kushtonin 9,8 miliard dollarë gjatë viteve 2006 dhe 2036. Megjithatë, për të adresuar faktin që kjo kosto ka nevojë që të sigurohet në nivel kombëtar, jo vetëm nga buxheti i shtetit. Ky plan shoqërohet dhe me një strategji financimi, i cili evidenton për të gjitha masat si dhe tregon ku do të jenë ndërhyrjet dhe siç shohim nga një shpërndarje gjeografike mjaft të gjërë, pra mbulohen shumë prej zonave, si në veri perëndim ashtu edhe veri, madje edhe në zonën perëndimore, ku është edhe zona bregdetare. Ndërkohë kemi dhe planin e veprimit për barazinë gjinore. Kemi planin e komunikimit dhe angazhimit të palëve dhe kornizën e monitorimit, vlerësimit dhe të nxënies. Ky plan nuk do të mbetet vetëm i miratuar, por do të ketë një vazhdimësi në monitorimin e zbatimit nga të gjitha institucionet. Ajo që vlen të

theksohet është që çdo masë, siç e përmenda, mbështet nga një kornizë e detajuar zbatimi dhe përcakton buxhetin, burimet e financimit, rolet, përgjegjësitë institucionale nën aktivitete për ekzekutiv dhe indikatorët e monitorimit që të dihet progresi në vijshmëri. Plani i veprimit, barazia gjinore, siç dihet për ndryshimet në fushën ndryshime klimatike ka një fokus dhe një rëndësi të veçantë. Kemi një plan veprimi për barazinë gjinore. Ndërkohë kemi dhe planin e komunikimit për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të pasur një qasje gjithëpërfshirëse, gjithë aktorëve, pushtet lokal, qendror, por edhe institucione, komunitete, qytetarët, në mënyrë që të rritet vëmendja ndaj këtij fenomeni dhe ndaj efekteve që ka ndryshimi i klimës në sektorët e ekonomisë. Strategjia financiare përcakton rrugëzimin e financimit për masat e adaptimit dhe siguron mobilizimin efektiv të burimeve për 6 masat. Përcaktohen pesë sektorë pasi disa prej masave janë ndërsektoriale, të cilat do të thotë që duke u zbatuar, japin efekte në disa sektorë. Kemi dhe dokumentin e monitorimit dhe vlerësimit të progresit të zbatimit të masave.

Komente:

Z. *Stiljan LLavdaniti* sqaroi se përsa i përket vendimit për miratimin e planit kombëtar për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, pranë sekretariatit teknik të agjencisë kanë mbërritur komente të bashkisë Tiranë. Janë me shkrim dhe ne do ti dërgojmë pasi të mbyllet mbledhja që të jemi konform edhe pjesës procedurale.

Shtojca 1: Të pranishëm në mbledhje

Anëtarët e Këshillit Konsultativ			
Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni	Institucioni/Organizata
1	Aldrin Dalipi	Kryetar	SHKQSH, Këshilli i Qarkut Tiranë
2	Fran Brahimi	Drejtor	Ministria e Financave
3	Elona Hoxha	Zv/ministër	Ministria e Drejtësisë
4	Elda Xhumari	Zv/ministër	Ministria e Mjedisit
5	Oriana Osmani	Zv/ministër	Ministria e Arsimit
6	Silva Caka	Zv/ministër	Ministria e Punëve të Brendshme
7	Enkelejd Musabelliu	Zv/ministër	Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit

8	Ermira Urupi	SHKQSH, Kryetar	Këshilli i Qarkut Elbasan
9	Ervis Moçka	SHKQSH, Kryetar	Këshilli i Qarkut Vlorë

Bashkëlidhur mund të aksesoni linkun për Këshillin Konsultativ datë 3 Shkurt.

[Mbledhja e Këshillit Konsultativ 3 Shkurt 2026 | Meeting-Join | Microsoft Teams](#)

Sekretariati Teknik i Këshillit Konsultativ E-mail: keshilli.konsultativ@amvv.gov.al Adresa: Bulevardi “Zhan d’Ark, ish- Shtëpia e Oficerave, Kati i VII”, Tiranë, Shqipëri.